



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës  
Opština Priština – Municipality of Prishtina

PRISHTINA



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja **d** të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15, qershor 2008), nenit 11, paragrafët 1, 2 dhe 4 të Ligjit nr. 04/L-144, për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 35/17, dhjetor 2012), nenit 33.2, shkronja **a**, dhe të nenit 34.1, shkronja **d**, të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më **31.10.2018**, merr këtë

**V E N D I M**

- I. MIRATOHET** propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të pronarëve Bedri (Smajl) Prishtina dhe Durim (Bedri) Prishtina.
- II.** Prona e paluajtshme komunale që do të jepet në këmbim, ka këto karakteristika: pjesë e parcelës kadastrale nr. 1414-0, Zona kadastrale (ZK) Matiçan, Certifikata e pronësisë nr. P-71914050-01414-0, PSH “rrugë publike e pakategorizuar” dhe parcelës kadastrale nr. 652-5, ZK Matiçan, certifikata e pronësisë nr. P-71914050-00652-5, PSH, Kuvendi Komunal Prishtinë, kurse prona e paluajtshme që merret nga ky këmbim, është pjesa e parcelës kadastrale nr. 4519 – 0, ZK Prishtinë, certifikata e pronësisë nr. P-71914059-04519-0, dhe parcelës kadastrale nr. 4518 – 0, ZK Prishtinë, nr. P-71914059-04518-0, pronë e planifikuar për interes publik, në pronësi të Bedri (Smajl) Prishtinës dhe Durim (Bedri) Prishtinës.
- III.** Këmbimi i pronave të paluajtshme është bërë pasi që nuk ekzistojnë parcela të tjera komunale të përshtatshme për realizimin e Planit rregullues “Mati 1 “ dhe PZHU-së. Kjo i shërben shfrytëzimit për qëllim të interesit publik të Komunës dhe kapitali për financimin e këmbimit është siguruar.
- IV.** Para shpalljes publike të vendimit, do të bëhet vlerësimi i kualifikuar i vlerës së tregut të pronës së paluajtshme komunale dhe vlerësimi i pronës private.
- V.** Mënyra dhe kushtet e këmbimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe pronarëve të parcelës që do të këmbehet.
- VI.** Pronat e paluajtshme komunale që do të këmbehen, të përshkruara në pikën II të këtij vendimi, duhet të evidentohen në librat kadastrale të Komunës.
- VII.** Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Pronës dhe Drejtoria e Kadastrit e Komunës së Prishtinës.



**VIII.** Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë shkresat e lëndës.

**IX.** Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

**KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**  
**01-463/01-0263696/18, më 01.11.2018**

**KRYESUESI I KUVENDIT**

**Agim Kuleta**

